

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: PLURAL SH.P.K.; ARBOR GROUP SH.P.K.; Pro & Co Group SH.P.K. me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	16.11.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **16.11.2021**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **PLURAL SH.P.K.; ARBOR GROUP SH.P.K.; Pro & Co Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **TRAJTIMI I SHITRETERVE TË PËRRENJVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - FAZA E DYTË**, me Numër të prokurimit: **623-21-3119-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-029-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pabazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **PLURAL SH.P.K.; ARBOR GROUP SH.P.K.; Pro & Co Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **TRAJTIMI I SHITRETERVE TË PËRRENJVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - FAZA E DYTË**, me Numër të prokurimit: **623-21-3119-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-029-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **11.11.2021**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **TRAJTIMI I SHITRETERVE TË PËRRENJVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - FAZA E DYTË**, me Numër të prokurimit: **623-21-3119-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-029-5-1-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: **PLURAL SH.P.K.; ARBOR GROUP SH.P.K.; Pro & Co Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **TRAJTIMI I SHITRETERVE TË PËRRENJVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - FAZA E DYTË**, me Numër të prokurimit: **623-21-3119-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-029-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **11.11.2021**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **16.11.2021**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Pretendimi ankimor 1 per LOT III:
Te kerketat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale, gjegjesisht tek mekanizmi, kerketa: Dy (2) papuqe vibruese (viber pllaka), grupi i OE i shpallur fitues ka dorezuar dokumentacionin per 2 viber pllaka, ku njera prej tyre e cila eshte ne emer te Globi – M.I. shpk i ploteson kushtet, ndersa viber pllaka tjeter e dorezuar nuk i ploteson kriteret, per shkak se eshte dorezuar vetem fatura blerese(fat.Nr.0527-07 e dt.27.05.2020- e blere nga Ndertimtari Beton shpk) dhe nuk eshte dorezuar DUDi doganor per te njejten, gje qe nuk e ploteson kerketen e AK ne DT.
Per shkak se Grupi i OE nuk ka dorezuar Dudin doganor per viber pllaken ne fjale, konstatojme se kjo kerkese nuk eshte permbushur.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Pretendimi ankimor 2 per LOT III:
Te kerketat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale, gjegjesisht tek mekanizmi, kerketa: Nje (1) Greder;
Per kerketen ne fjale, grupi i OE i shpallur fitues ka dorezuar nje fature blerese per nje greder, fat. me Nr.1/2010 e dt.10.03.2010, mirepo nuk ka dorezuar edhe DUD Doganor per grederin ne fjale, kur kihet parasysh fakti se grederi sikurse paisjet tjera, duhet te kene Dudin Doganor, i cili kompletton dokumentacionin sa i perket pronesise se nje mjete. Pra, konstatojme, se me faktin qe grupi i OE i shpallur fitues nuk ka dorezuar DUD Doganor per Greder, kjo kerkese nuk eshte permbushur.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Pretendimi ankimor 3 per LOT III:
Te kerketat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale, gjegjesisht tek mekanizmi, kerketa: Nje (1) Buldozer shtyes, mbi 12 ton:
Grupi i OE i shpallur fitues ka dorezuar dokumentacionin per nje Eskavator CAT 973, i cili ne realitet, bazuar edhe ne foton te cilen e ka prezantuar ne dosje Grupi i OE i shpallur fitues, si dhe bazuar ne pershkrimin qe i njejti e ka ne DUD Doganor, rezulton te jete nje eskavator, i cili ne pjesen e perparme, nuk ka luge shtyese, mirepo ka luge ngarkuese, gje qe nuk e ploteson kerkesen nga AK. Poashtu, per te vertetuar kete, mjafton nje kerkim ne Google me pershkrimin CAT 973, dhe do shfaqet paisja e cila ne realitet eshte per ngarkim. Poashtu pershkrimi ne DUD doganor eshte eskavator dhe nuk eshte Buldoziere, sic eshte dashur ta kete ne realitet. Poashtu per te njejtin, grupi i OE i shpallur fitues, ka dorezuar DUD Doganor ne emer te Euro Invest SHPK, ndersa Grupi i OE i shpallur fitues, gjegjesisht "Mirusha Company shpk", per te njejtin ka dorezuar fature blerese nga "N.T.SH. SHPETIMI", qe do te thote se ka mungese dokumentacioni, per shkak se nuk eshte dorezuar fatura e cila deshmon se paisjen ne fjale kompania "N.T.SH. SHPETIMI" e ka blere nga kompania Euro Invest SHPK, dhe me pas ja ka shitur kompanise "Mirusha Company shpk", pra mungon lidhja mes ketyre dokumenteve.
Prandaj, konstatojme se kjo kerkese nuk eshte e permbushur nga Grupi i OE i shpallur fitues.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

Pretendimi ankimor 4 pe LOT III:
Te kerketat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale, gjegjesisht tek mekanizmi, kerketa: Dy (2) Eskavator 15-20 ton:
Grupi i OE i shpallur fitues, ka dorezuar dokumentacion per dy eskavator, mirepo vetem njeri prej tyre e ploteson kerkesen ne fjale. Kete e konstatojme per faktin se njeri prej eskavatoreve te dorezuar me DUD doganor te dates: 28.12.09, ka peshe 14000 kg, gje qe

4/3

F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK

eshte ne kundërshtim me kerkesen e AK. Rrjedhimisht kjo kerkese nuk eshte permbushur pasi qe ne fakt grupi i OE i shpallur fitues ka dorezuar vetem nje eskavator qe ploteson kete kerkese, ndersa kerketa nga AK ka qene per dy eskavatore te tille.
Prandaj, konstatojme se kjo kerkese nuk eshte permbushur nga Grupi i OE i shpallur fitues.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMOR Nr. 1 & 2 & 3 & 4:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë për LOT III - NDËRTIMI I KANALIT TË KULLIMIT NË FSHATIN SAPNIQ, ka prezantuar **LISTËN E PAJISJEVE DHE MJETEVE TË PUNËS**, në pajtim me Kërkesën 5 / Dëshminë 5, të Kapacitetit teknik dhe profesional sipas FDT-së

Tek Dëshmia Nr. 5 të Kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar:

Dëshmia 5: Lista origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik e pajisjeve – mjeteve të punës në dispozicion për realizimin e punimeve.

Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen.

Në Dosjen e Tenderit, tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), tek Dëshmia e Kërkuar dokumentare të dëshmisë 5 lidhur me pajisje është kërkuar si dëshmi, njëri nga dokumentet si më poshtë:

- a. Deklaratat unike doganore;*
- b. Kontrata, ose*
- c. Fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen*

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar njërin nga dëshmitë të kërkuar dokumentare sipas FDT-së

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju mundë të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit